



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 12.05.2023

Nr: 105

Ora: 14:10

VENDIM

**PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS NR. 27, DATË 11.05.2023 TË KOMISIONERIT SHTETËROR TË
ZGJEDHJEVE**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 12.05.2023, me pjesëmarrjen e:

Elvin	LAKO	-	Relator
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

KËRKUES: Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

OBJEKT: Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ ndaj z. Gledian Llatja, kryetar i bashkisë Elbasan; ndaj z. Arif Tafani, kryetar i bashkisë Belsh.



BAZË LIGJORE:

Neni 19, pika 1, shkronja "c" dhe neni 21, pika 1, shkronja "dh" të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

Rrethanat e çështjes:

1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka marrë denoncime për organizimin e veprimtarive publike nga dy institucione publike, konkretisht për bashkitë Elbasan dhe Belsh, për të cilat pretendohet se janë shkelur parashikimet e nenit 91 dhe nenit 92 të Kodit Zgjedhor.
2. Mbi këtë bazë, Komisioneri ka nisur hetimin administrativ, në përfundim të të cilit, ka vënë në lëvizje KAS-in me anë të një kërkesë, duke kërkuar marrjen e masës administrative me gjobë ndaj kryetarëve të bashkisë Elbasan dhe Belsh në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë.
3. KAS-i caktoi me short z. Elvin Lako relator për shqyrtimin e kërkesës nr. 27, datë 11.05.2023 të Komisionerit dhe në seancën paraprake vendosi pranimin për shqyrtim të kërkesës, duke e caktuar seancën e shqyrtimit më 12.05.2023, ora 14:10.
4. Seanca e datës 12.05.2023 u zhvillua me praninë e Sekretarit të Përgjithshëm të KQZ-së, si përfaqësues i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe të specialistëve të administratës së KQZ-së. Kryetarët e bashkive ose përfaqësues të tyre, të njoftuar rregullisht, nuk u paraqitën në seancën e shqyrtimit.
5. KAS-i mori në shqyrtim dhe administroi:
 - Kërkesën nr. 27, datë 11.05.2023 të Komisionerit;
 - Vendimin e Komisionerit nr. 480 datë 10.05.2023 "Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve";
 - Denoncimet nr. 239, 240, 241, 242 ID për bashkinë Elbasan;
 - Denoncimin nr. 210 ID për bashkinë Belsh;

Në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe të vlerësimit të provave dhe pretendimeve përfundimtare,

KAS-i konstaton:

1. Denoncimet me nr. 239, 240, 241, 242 ID ndaj Bashkisë Elbasan si dhe denoncimi me nr. 210 ID ndaj bashkisë Belsh, i referohen veprimtarive të zhvilluara gjatë muajit mars 2023. Komisioneri, pas hetimit administrativ të këtyre denoncimeve ka konstatuar se *“përdorimi i aktiviteteve të organizuara nga institucione publike për të kryer thirrje elektorale në mbështetje të një force politike apo kandidati të caktuar, përbën shkelje të detyrimeve të nenit 91 të Kodit Zgjedhor. Kryetarët e bashkive të sipërcituara, nëpërmjet vënies në dispozicion të këtyre aktiviteteve për kryerjen e thirrjeve elektorale, kanë shkelur parashikimet e këtij neni”*.
2. KAS është shprehur në vendime të mëparshme lidhur me këtë lloj shkeljeje të pretenduar dhe ka rrëzuar kërkesat e Komisionerit me arsyetimin si vijon.
3. Pika 1 e nenit 91 nuk lejon që kryetari i bashkisë të përdorë ose të vërë në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve NË ZGJEDHJE burime të institucionit që drejton, si në formën e aseteve, ashtu dhe në formën e burimeve njerëzore. Asetet i ka përcaktuar neni 142 i Kodit Civil. Ato janë sende të luajtshme apo të paluajtshme. Veprimtaria në vetvete nuk është send, nuk formon aset, nuk mund të jetë burim, për pasojë nuk mund të bëjë pjesë në objektin e dispozitës së nenit 91, pika 1. Gjatë veprimtarisë mund të përdoren sende, të cilat formojnë asete dhe që janë burime. Por këto sende duhet të identifikohen, të saktësohet pronësia apo të drejtat reale të bashkisë mbi to, përpara se veprimtaria të konsiderohet veprimtari e ndaluar dhe kryetari i bashkisë të merret në përgjegjësi administrative.
4. Lista e veprimtarive të ndaluara, sipas pikës 1 të nenit 3 të vendimit të Rregullatorit nr. 9, datë 24.12.2020, është listë e numërtuar (nga “a” tek “dh” e nën pikës 1.3), sikurse është e numërtuar lista e veprimtarive të ndaluara për t’u promovuar (nga “a” tek “d” e nën pikës 1.1). Kjo do të thotë se llojet e veprimtarive të ndaluara dhe të veprimtarive të ndaluara për t’u promovuar janë të përcaktuara në mënyrë strikte. Atyre nuk mund t’u shtohen lloje të

reja veprimtarie, nuk mund të pasurohen as nga Komisioneri, as nga KAS-i. Lista mund të pasurohet vetëm në rrugën e amendimit të vendimit të Rregullatorit nr. 9, datë 24.12.2020. “Përdorimi i aktivitetit të organizuar nga një organ publik” nuk bën pjesë në listën e veprimtarive sipas nënpikës 1.3 të pikës 1 të nenit 3, nuk formon dot “veprimtari të ndaluar”.

5. Veprimtaritë e denoncuara janë veprimtari me karakter të qartë politik/elektoral. Ato janë zhvilluar në kuadër të veprimtarive politiko-elektorale të Partisë Socialiste, gjegjësisht në dobi të saj. Ndryshe nuk ka shpjegim, as justifikim, pjesëmarrja në veprimtari e drejtuesit politik të Qarkut. Pjesëmarrja e kryetarëve të Bashkisë Elbasan dhe Belsh, gjithashtu, mund të vlerësohet në këtë kontekst, sa kohë që kryetari i bashkisë ka qenë në momentin e zhvillimit të veprimtarisë kandidat i subjektit “Partia Socialiste” për zgjedhjet e datës 14 maj 2023. Veprimtaritë në dobi të subjektit politik nga ana e këtyre zyrtarëve shtetërorë nuk janë, në vetvete, të kundërligjshme. Vetëm koha kur kryhen ato mund të shkaktojë përplasje me ligjin.
6. Pika 1 e nenit 91 të Kodit Zgjedhor përcakton se “...nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve NË ZGJEDHJE burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia”. Kjo dispozitë është përsëritur në mënyrë të ngjashme edhe nga vendimi i Rregullatorit nr. 9, datë 24.12.2020 në përkufizimin e “veprimtarive të ndaluara” kur ndalon “vënien në dispozicion të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme ... për QËLLIME ZGJEDHORE”.
7. Kodi ka përcaktuar periudhën e fushatës zgjedhore, si një periudhë që zgjat nga 30 ditë para datës së zgjedhjeve, deri 24 orë para datës së zgjedhjeve (neni 77), ka përcaktuar periudhën kur nuk lejohet propozimi, miratimi ose nxjerrja e akteve të caktuara ligjore ose nënligjore, e cila është katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve (pika 4 e nenit 91), por nuk ka përcaktuar periudhën kur vepron ndalimi sipas pikës 1 të nenit 91, kur fillojnë “ZGJEDHJET” dhe as kur mbarojnë ato. Nga ana tjetër nuk ka asnjë akt me karakter normativ nga ana e KQZ-së që të përcaktojë momentin kur fillon të veprojë ndalimi i përdorimit të burimeve të organeve apo enteve publike që kërkon ky nen. Vendimi

i Rregullatorit nr. 9, datë 24.12.2020 nuk e ka saktësuar këtë përkufizim. Në nënpikën 1.3, të pikës 1 të nenit 3 të tij, teksa jep përkufizimin e “veprimtarive të ndaluara”, vendimi vendos afatin për të cilin vepron ndalimi për secilën nga kategoritë e veprimtarive të ndaluara, me përjashtim të veprimtarive të përkufizuara nga shkronja “c” dhe nga shkronja “dh” e tij, për të cilat nuk ka afat.

8. Në kushtet e mungesës së një përcaktimi detyrues që do t’ua vendoste fillimin e veprimit të afatit të ndalimit në një datë më të hershme, subjektet zgjedhore dhe institucionet janë të lira ta çojnë afatin në limitin e tij ligjor, që është data e fillimit të fushatës zgjedhore, d.m.th. 30 ditë përpara datës së zgjedhjeve. Kjo nuk do të formonte shkelje të ligjit, sepse “PERIUDHA E FUSHATËS ZGJEDHORE”, sikurse është përcaktuar nga Kodi Zgjedhor e mbulon konceptin “ZGJEDHJE” të pikës 1, të nenit 91.
9. KAS-i mund të marrë masa administrative ndaj subjekteve ose përfaqësuesve të institucioneve vetëm nëse konstaton shkeljen e dispozitave të caktuara detyruese ligjore, por nuk mund të sanksionojë administrativisht për veprime, të cilat nuk është ligjërisht e qartë nëse janë kryer brenda apo jashtë periudhës së ndalimit. Kuadri ligjor i paqartë nuk mund të zbatohet në dëm të subjekteve. Ndëshkim pa shkelje dhe pa faj nuk mund të ketë.
10. Bazuar në këtë analizë të fakteve dhe të kuadrit ligjor, KAS nuk e gjet të mbështetur kërkesën për vendosjen e sanksionit administrativ ndaj kryetarëve të bashkisë Elbasan dhe Belsh, dhe as procedimin e subjektit zgjedhor përfitues. Në mungesë të përcaktimit ligjor të afatit kur vepron ndalimi sipas pikës 1 të nenit 91 të Kodit Zgjedhor, është e pamundur që veprimtaria e denoncuar të cilësohet “veprimtari të ndaluar”, përveçse pasi të ketë filluar “periudha e fushatës zgjedhore”.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 21, pika 1, shkronja 'dh', të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Rrëzimin e kërkesës së Komisionerit për vendosjen e sanksioneve administrative.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga shpallja e tij.

Elvin	LAKO	-	Relator
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar (Kundër)
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar (Kundër)

MENDIM PAKICE

1. Në shqyrtimin e kërkesës nr. 27, datë 11.05.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me objekt *“Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ”*, ne, anëtarët në pakicë, duke mos qenë dakord me konkluzionet dhe argumentet e parashtruara nga shumica e anëtarëve të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (në vijim KAS) jemi të mendimit se KAS duhet të pranonte kërkesën e KSHZ për vendosjen e sanksionit administrativ ndaj:

- z. Gledian Llatja, Kryetar në Bashkinë Elbasan; dhe
- z. Arif Tafani, Kryetar në Bashkinë Belsh;

2. Në lidhje me Bashkinë Elbasan, KSHZ i është drejtuar KAS me kërkesë për vendosje sanksioni administrativ ndaj kryetarit të bashkisë për katër aktivitete. Të katërt aktivitet kanë qenë të organizuar nga Bashkia Elbasan dhe të raportuara në ndërfaqen e KQZ po nga Bashkia Elbasan. Në të katërt aktivitetet, përveç pjesëmarrësve, kanë qenë të pranishëm edhe drejtuesi politik i Partisë Socialiste për qarkun Elbasan, z. Damian Gjijnuri dhe deputetë të tjerë të Partisë Socialiste të Qarkut Elbasan, si znj. Evis Kushi, znj. Desantila Tahihiraj dhe z. Luan Duzha.

Aktiviteti i parë është raportuar nga Bashkia Elbasan me titull *“Inspektim i punimeve ne rruget e Rajonit nr.5 dhe 6”*. Nga fjala e drejtuesit politik të PS qarku Elbasan, rezulton ndër të tjera se ai është shprehur *““(...) Unë them se ky e ka bërë mirë këtë punë katër vitet e kaluara. Jam i bindur që do marrë prapë mbështetjen e qytetarëve të Elbasanit sepse ky do të bëjë dy fish më shumë. Ja u garantoj që punët e nisura nuk do përfundojnë me kaq. Se këtë ndaj e ka përzgjedh Edi Rama, ta ketë mëkëmbësin e tij në kuptimin politik të fjalës në bashki, me qëllim që projektet e nisura të vazhdojnë. Unë nga ana tjetër ju them një gjë që ne jemi modeli i punëve, bëjmë dhe gabime nuk jemi perfekt, kemi edhe ne të meta, ama nuk merremi me llafet e politikës së madhe, Elbasani bunker, si krahu tjetër që e do thjesht për trofe politik Elbasanin se s’ka asnjë projekt. Ne na duhet që këto punë të nisura të vazhdojnë dhe të kemi edhe qeverinë e Edi Ramës nga mbrapa që Elbasani të ndryshojë në çdo cep të tij. Unë ju uroj suksese.”*.

Aktiviteti i dytë është raportuar nga Bashkia Elbasan me titull *“Inspektim i punimeve”*. Nga fjala e drejtuesit politik të PS qarku Elbasan, rezulton ndër të tjera se ai është shprehur *““(...) Qytetarët e Elbasanit e kanë kuptuar që këtu ka një investim të përditshëm, ka një kujdes nga kryetari i bashkisë,*

por mbi të gjitha Gledi nuk është vetë, ai është përfaqësuesi i Edi Ramës. Ne nuk e ndryshojmë dot Elbasanin pa pasur mbështetjen e qeverisë. Ne nuk duam ta kemi Elbasanin bunker politik i Sali Berishës. Sepse mëkëmbësi i tij do ta kthejë Elbasanin në foltore të Sali Berishës. Elbasani nuk është për foltore, Elbasani ka qenë foltore për arsimin, për gjëra të mëdha, por nuk është për beteja politike të Sali Berishës. Oferta jonë nëpërmjet Gledit është çdo vit ndërhyrje në çdo cep të bashkisë së Elbasanit, qoftë në qytet edhe në fshat për ta ndryshuar infrastrukturën e zonës (...)”.

Aktiviteti i tretë është raportuar nga Bashkia Elbasan me titull “Inspektim i punimeve ne rruget e Njesise Administrative Bradashesh”. Nga fjala e drejtuesit politik të PS qarku Elbasan, rezulton ndër të tjera se ai është shprehur “(...) Kandidati i bashkisë nuk është vetëm, por ka ekip, ka qeverinë, ka projekte, ka vizion për Elbasanin. Prandaj unë mendoj dhe shpresoj që njerëzit të na japin mbështetjen për të vazhduar punën për të mirat e Elbasanit. Njerëzit ikin e vijnë, e rëndësishme është puna të mbetet. Nëpërmjet punës që po bën kryetari i bashkisë, bashkë me gjithë ekipin, me deputetin, të gjithë siç jemi t’i shtyjmë përpara të gjitha këto punë sepse kemi dhe mbështetjen e qeverisë, po dhe Gledi vetë është shumë i futur bashkë me administratorin, ka bërë dëgjesat e lagjeve, ka marrë shënim çfarë duhet, ka vënë një prioritet. Këtë vit do bëjmë këto, vitin tjerët diçka tjetër, dhe kjo është garancia. Krahu tjetër ka vetëm një moto: si të sjellim revolucionin e foltores nga Tirana në Elbasan. Elbasanllinjtë s’para i kanë qejf këto. Elbasanllinjtë duan jetën e qetë, nuk duan betejat politike, nuk duan këto luftërat e Tiranës. Duan të përmirësojnë jetën e tyre, ta bëjnë Elbasanin e bukur. Dhe unë them kjo është qasja që ne kemi, ky është premtimi jonë për Elbasanllinjtë.”

Aktiviteti i katërt është raportuar nga Bashkia Elbasan me titull “Inspektim i punimeve ne Njesine Administrative Shushice”. Nga fjala e vetë kryetarit të bashkisë Elbasan, z. Gledian Llatja, rezulton ndër të tjera se ai është shprehur “(...)Kemi treguar se jemi vetëm për punë, ne dimë të bëjmë vetëm punë, jo si të tjerët që dinë të bëjnë vetëm llafe, ne këtë kemi dashur dhe këtë po bëjmë, t’i qëndrojmë afër qytetarëve dhe banorëve në qytet, në fshat, në zonat periferike, edhe në zonat më të thella, pikërisht për këtë. Qëllimi ynë është që të kemi një bashkëpunim midis strukturave vendore dhe qytetarëve ashtu si e kemi pasur deri tani, me besimin për të vazhduar punë, pasi qytetatarët kanë halle, ndaj ne duam punë. Ne nuk kemi as hallet e Sali Berishës as të Ilir Metës, ata t’i dalin vetë për Zot halleve të veta, ne jemi për hallet e popullit. Ne për këtë jemi, jemi të gjithë bashkë, nuk jemi vetëm, kemi edhe mbështetjen e madhe të qeverisë, ashtu edhe siç shihet po bëhen edhe pritrat lumor në lumin Shkumbin, të cilat nuk shkaktojnë më përmytje, janë investime të mëdha që na ka

mbështetur qeveria. Në mënyrë aktive filluam të bëjmë punë në të mirë të komunitetit, pasi ne këtë dimë të bëjmë të mirë menaxhojmë të administrojmë. (...) Këto investime është e vërtetë që duhet të ishin bërë para 30 vitesh, dhe ne po i bëjmë, ndërsa opozita nuk ka bërë asgjë. Katër vite kur ishin në pushtet asnjëherë nuk u kujtuan për Hajdaranin, as për Shushicën, as për rrugët, ndërsa tani thonë nuk është bërë kjo rrugë, këtë se bën Zoti , ne po e bëjmë, dhe po punojmë çdo ditë. Nuk është e moralshme të dalësh para një fushate dhe të thuash se kjo rrugë nuk është bërë”

Siç rezulton nga përmbajtja e fjalimeve në aktivitetet e sipërcituara që janë organizuar nga Bashkia Elbasan, janë mbajtur fjalime me përmbajtje politike dhe elektorale nga përfaqësuesi politik i PS në Elbasan apo dhe nga vetë Kryetari i Bashkisë Elbasan.

Komisioni Rregullator pranë KQZ, në zbatim të detyrimeve të parashikuara nga nenet 90 dhe 92 të K.Zgjedhor, ka nxjerrë vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”. Në nenin 1 të këtij vendimi që përcakton qëllimin dhe objektin e tij, Komisioni Rregullator, ka përcaktuar se ky akt normativ është nxjerrë “... **me synim garantimin dhe sigurimin e paanshmërisë dhe trajtimit të barabartë të kandidatëve dhe të partive politike, krijimin e kushteve të drejta e të barabarta për të gjithë kandidatët dhe partitë politike që marrin pjesë në procesin zgjedhor, si dhe për mospërdorimin e fondeve dhe të burimeve publike për qëllime partiake**”. Në nenin 7 shkronjat “dh” dhe “e” të këtij vendimi ku parashikohen detyrat e sekretarëve të përgjithshëm të institucioneve publike, të pavarura e të varësisë, ndër të tjera parashikohet se “1. Sekretarët e përgjithshëm të institucioneve publike qendrore e vendore, të pavarura e të varësisë, **kryetarët e bashkive, prefektët, drejtuesit e njësive administrative dhe drejtuesit e institucioneve të varësisë: ... dh) marrin masa për ndalimin e iniciativave elektorale ndikuese, diktuese dhe urdhëruese apo të propagandës politike, në funksion të fushatës zgjedhore, në institucionet publike përkatëse; e) marrin masa dhe realizojnë monitorimin e zbatimit të tyre, për të penguar keqpërdorimin dhe garantuar mospërdorimin e: ... v) veprimtarisë shtetërore për të favorizuar subjekte të caktuara zgjedhore**”.

Për ne anëtarët në pakicë, është e qartë që shfrytëzimi i aktiviteteve të organizuara nga Bashkia Elbasan për përcjelljen e mesazheve elektorale propagandistike apo për të anatemuar kundërshtarin

politik të partisë politike që ka mbështetur dhe mbështet kryetarin e bashkisë në detyrë, cënon sigurimin e paanshmërisë dhe trajtimit të barabartë të kandidatëve dhe të partive politike dhe krijon kushte të pabarabarta (disfavorizuese) për kandidatët e tjerë apo për partitë e tjera politike që marrin pjesë në zgjedhje. Nëse një sjellje e tillë e një kryetari bashkie nuk do të konsiderohej në kundërshtim me qëllimin dhe objektin e vendimit të sipërcituar të Komisionit Rregullator, atëherë duhet të pranojmë se kemi të bëjmë me një akt normativ të pazbatueshëm. Po në të njëjtin përfundim do të dilej edhe në lidhje me nenin 91 të K.Zgjedhor nëse do të pranohet që aktivitete si ato të organizuara nga Bashkia Elbasan nuk çënojnë sigurimin e paanshmërisë dhe trajtimit të barabartë të kandidatëve dhe të partive politike. Është alogjike të mendosh se një aktivitet i organizuar nga Bashkia Elbasan, mund të organizohet pa përdorur asnjë burim të saj, në kuptim të burimeve sipas nenit 91 të K.Zgjedhor. Dy janë mundësitë për të organizuar aktivitete të tilla: 1. Aktivitet i organizuar nga Bashkia Elbasan dhe që ka përdorim të burimeve të Bashkisë Elbasan; ose 2. Aktivitet politik i kandidatit për Bashkinë Elbasan me burime që duhet të deklarohen nga partia politike që e mbështet ose vetë kandidati në kuptim të fushatës zgjedhore. Një aktivitet me status të ndryshëm nga këto më sipër, nuk mund të ketë ku organizator të jetë Bashkia Elbasan apo Kryetari i Bashkisë Elbasan.

Ndaj, për sa më sipër, KAS duhet të pranonte kërkesën e KSHZ për vendosjen e sanksionit administrativ ndaj Kryetarit të Bashkisë Elbasan, z. Gledian Llatja.

3. Në lidhje me Bashkinë Belsh, rezulton se kryetari i Bashkisë Belsh, në faqen e tij në rrjetin social Facebook ka publikuar zhvillimin e një aktiviteti me përshkrimin *“Belsh- Bashkëbisedim me fermerët, për krijimin e Grupit Vendor të Veprimit, që duke u bërë bashkë u krijohet mundësia për të marrë më shumë financim. #TëBashkuarJoTëNdarë #ShqipëriaeArdhmjaJonë #SkaKohëPërPushim”*. Një postim lidhur me këtë aktivitet ka bërë edhe Drejtuesi Politik i Qarkut Elbasan, Deputeti, z. Damian Gjijnuri duke përshkruar *“Në Belsh ku bashkë me Arifin dhe ekspertin e fushës Ermal Elezi zhvilluam një bashkëbisedim me fermerë, pronarë të bujtinave e sipërmarrës në fushën e agro-turizmit për iniciativën e krijimit të Grupit Vendor të Veprimit në zonën e Dumresë. Aplikimi i kësaj skeme, e njohur edhe në vendet e Bashkimit European me të cilët kemi përafuar edhe legjislacionin shqiptar, do sjellë bashkëpunimin e aktorëve të zonës duke fuqizuar më tej dy sektorë të rëndësishëm për Belshin, agro-turizmin dhe bujqësinë. Kjo nënkupton edhe më shumë financim nga Bashkimi*

EuropeanEU sikurse është edhe aplikimi i programit "IPARD". #TëBashkuarJoTëNdarë #ShqipëriaeArdhmjaJonë#SkaKohëPërPushim".

Mosraportimi i prezencës së drejtuesit politik të Partisë Socialiste në Qarkun Elbasan, z. Damian Gjikhuri, ngarkon me përgjegjësi Kryetarin e Bashkisë Belsh për aq kohë sa provohet që ai ka qenë një nga pjesëmarrësit që ka mbajtur fjalë në këtë aktivitet.

Ndaj, për sa më sipër, KAS duhet të pranonte kërkesën e KSHZ për vendosjen e sanksionit administrativ ndaj Kryetarit të Bashkisë Belsh, z. Arif Tafani.

Anëtarë: Elvis Çefa, Ledio Braho